



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTVENDMIT

“PËR STRATEGJINË KOMBËTARE PËR MOSPËRHAPJEN E ARMËVE TË
DËMTIMIT NË MASË DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ”

1. Titulli i projektaktit

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Me urdhër të Kryeministrit nr.183, datë 17.09.2024, është ngritur grupi i punës “Për hartimin e strategjisë kombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe planit të veprimit për zbatimin e saj”.

Projektakti është publikuar në RENJKP për konsultim, nga data 10 prill 2025 deri më datë 8 maj 2025, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, u konsultua:

- **Nëpërmjet RENJK:**

Me publikimin në RENJK (<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/830>), u vendos një afat 20 ditor, nga data 10 prill 2025 deri më datë 8 maj 2025, për dhënien e sugjerimeve/komenteve mbi draftin e projektvendimit.

- **Nëpërmjet adresës së emailit:**

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas draftit të projektvendimit është vënë në dispozicion edhe adresa elektronike konsultim.publik@mod.gov.al.

- **Nëpërmjet adresës postare: “Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë”:**

Çdo palë e interesuar mund të dërgonte në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektvendimit.

- **Nëpërmjet takimeve konsultative :**

Institucionet që kanë dhënë kontribut për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë, bazuar në urdhrin e Kryeministrit janë:

- Ministria e Brendshme;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pranë Ministrisë së Financave;
- Instituti i Fizikës Bërthamore, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;
- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Agjencia e Inteligjencës Financiare;
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;
- Shërbimi Informativ i Shtetit;
- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projektakti janë:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;
- Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektvendimi nuk ka marrë komente në rubrikën përkatëse në RENJKP apo në takime konsultative.

Nr.	Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
-----	--	---	--	---	-------------